

**“Reformat, drejtimi i duhur për në BE – Reforma në fushën e kontabilitetit, raportimit financiar dhe auditimit”**

Duke patur parasysh aspiratën për hyrjen në BE, Qeveria Shqiptare po përafron kudrin ligjor dhe institucional me *acquis communautaire të BE*. Në këtë kontekst, përmirësimi i përgjegshmërisë dhe transparencës në fushën e raportimit financiar është një objektiv i rëndësishëm.

Ministria e Financave, ndërkohë, po ndërmerr një sërë reformash ambicioze me qëllim përmirësimin e ekonomisë shqiptare dhe arritur rritjen ekonomike të synuar. Këto reforma, synojnë në tërësinë e vet, lehtësimin e dhe përmirësimin e kushteve të mjedisit të biznesit.

Në këtë kontekst, reformat në fushën e kontabilitetit dhe auditimit luajnë një rol të rëndësishëm. Aksesin në informacionin financiar cilësor është një element kyç i ekonomisë së tregut i cili çon në rritjen e besimit të sistemit financiar në vend duke ndikuar në shpërndarje më eficiente të burimeve në sektorin privat.

Në të njëjtën kohë, përveç krijimit të stabilitetit financiar, një informacion financiar cilësor ndikon edhe në besimin e investitorëve ndaj bizneseve që kanë nevojë për financime, si dhe kontribuon në krijimin e një bazë të taksueshme të besueshme për shtetin, si burim kryesor i të ardhurave publike.

Për sa më sipër, reformat e ndërmarra në këtë fushë kanë patur këto synime kryesore:

- Përmirësimi i kuadrit rregullator në lidhje me raportimin financiar;
- Krijimi i strukturave të qëndrueshme për prodhimin e standardeve me cilësi të lartë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit;
- Krijimin e mekanizmave monitorues dhe mbikëqyrës që garantojnë zbatueshmërinë e standardeve në këtë fushë;
- Rritja e profesionalizmit të kontabilistëve dhe audituesve për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raporteve të auditimit me cilësi të lartë.

Për këtë, janë përgatitur:

- Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”;
- Ligji nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”;
- Plani Kombëtar i Veprimit (2009)

Më konkretisht, si pjesë e këtyre reformave, janë realizuar:

- Futja dhe zbatimi i SNRF-ve nga kompanitë e mëdha (me të ardhura vjetore 1.25 miliardë lekë dhe më shumë se 100 punonjës, institucionet financiare dhe kompanitë e listuara).
- Janë duke u zbatuar 14 SKK, (SKK të përmirësuara janë në zbatim që prej 2015, në përputhje me kërkesat e direktivës dhe SNRF për SME-të);
- Gjithashtu, është përgatitur SKK 15 për mikro-njësitë dhe një standard për OJF-të.
- U krijua Bordi i Mbikëqyrjes Publike (2009)
- U caktuan kufijtë për auditimet ligjore (të detyrueshme)

- Kryerja e kontrollove të cilësisë nga ana e organizatës së profesionale (nën mbikëqyrjen e Bordit

Reformat e ndërmarra në 2016 e më tej:

- Në Prill të 2016 janë miratuar nga Parlamenti shqiptar ndryshimet në ligjin e auditimit ligjor, ku theksi është vënë në :
  - o Rritjen dhe forcimin e pavarësisë dhe rolit të BMP (nëpërmjet financimit të tij dhe rritjes së profesionalizmit: Bordi do të sigurojë burime të veta të financimit, dhe në të njëjtën kohë do të mbështet nga një strukturë shumë profesionale për kryerjen e kontrolleve të cilësisë).
  - o Janë përcaktuar përkufizime të reja për njësitë ekonomike me interes publik, jo praktikues, auditues ligjor, etj., në përputhje me direktivën.
  - o Kontrollat e cilësisë, për njësitë me interes publike janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e BMP, ndërkohë që për njësitë e tjera edhe pse mund të delegohet tek organizata profesionale, përgjegjësia sërish është e Bordit dhe mund ta rimarrë këtë të drejtë në cdo moment.
- Ligji i kontabilitetit dhe pasqyrave financiare do të rishikohet, për harmonizëm të mëtejshëm me direktivën, si dhe për të reflektuar problematikat e dala nga zbatimi në praktikë deri tani. Kështu, do të rregullohet përgjegjësia për hartimin dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare, unifikohet i terminologjisë në këtë fushë, me direktivën, rregullohet raportimi financiar për rregullatorët në sektorin bankar, jobankar dhe financiar, si dhe një sërë rregullimesh të tjera të cilat do të përmirësojnë zbatueshmërinë e ligjit dhe rritjen e cilësisë së raportimit financiar. Aktualisht, është përgatitur një draft i këtij ligji, dhe është duke u punuar për përgatitjen e tabelës së transpozimit, në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore.
- Një fokus i vecantë, do të jetë edhe administrata tatimore. Në kuadër të projektit bashkëpunues me BB, synohet rritja e kapaciteteve të kësaj administrate për të kuptuar më mirë standardet e kontabilitetit duke bashkërenduar kështu diferencat që ekzistojnë ndërmjet raportimit financiar për qëllime fiskale dhe raportimit financiar për qëllime të përgjithshme. Në këtë kuadër, përveç trajnimeve, do të përgatiten një sërë udhëzimesh dhe manuale me shembuj praktikë për inspektorët tatimorë.
- Ndërkohë, do të punohet që brenda këtij viti të përditësohet edhe Plani i Kombëtar i Veprimit në këtë fushë, për të reflektuar reformat e ndërmarra, si dhe të përfshirë zhvillimet e reja në këtë fushë në kontekstin lokal, rajonal dhe me gjerë.

Ministria e Financave, ndërkohë, mbetet e përkushtuar për të shtyrë më tej reformat në këtë fushë me synimin për përmirësimin dhe përforcimin e mëtejshëm të cilësisë së raportimit financiar, si një element mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë shqiptare

Do të doja ta mbyllja këtë diskutim duke ritheksuar një shprehje të Harald Waiglen, Drejtor i Përgjithshëm për Politikën Ekonomike dhe Tregjet Financiare në Ministrinë e Financave të Austrisë, theksuar shpesh gjatë Konferencës Ministeriale që u mbajt në Vjenë në data 26 – 28 Prill të këtij viti: “T’u japësh investitorëve informacion financiar transparent e të besueshëm, është gjëja më e mirë që mund të bëhet për rritjen ekonomike”.

Ju faleminderit.